



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 3427 Prot.

Tiranë, më 16.05.2018

URDHËR

Nr. 315, datë 16.05.2018

**PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
PROPOZIMIT TË BASHKISË TIRANË LIDHUR ME KERKESËN PËR ZHVILLIMIN
E ZONËS PRANË TEATRIT KOMBËTAR**

Në vijim të kërkesës nr. 186 prot., datë 9.3.2018, të Teatrit Kombëtar për vlerësimin e gjendjes së godinës së Teatrit Kombëtar për shkak amortizimit të saj, dhe shkresës nr. 6848/6 prot., datë 14.5.2018, paraqitur nga bashkia Tiranë, për realizmin e projektit të zhvillimit urban në zonën midis Teatrit Kombëtar dhe qendrës tregtare “*Toptani*”, si edhe midis rrugëve “*Murat Toptani*” dhe “*Abdi Toptani*”, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social-kulturor të qytetit të Tiranës, të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe pikes 5, të nenit 16, të ligjit nr. 90/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës me qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimit të paraqitur nga bashkia Tiranë, për zhvillimin e zonës pranë Teatrit Kombëtar.
2. Grupi i punës ka përbërje si më poshtë:
 - a) Z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës Kryetar;
 - b) Znj. Kozeta Angjeliu, Drejtor në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Kulturës Anëtar;
 - c) Zj. Herida Duro, Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor Anëtar;
 - d) Z. Arian Avrazi, Drejtor në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës Anëtar;
 - e) Z. Shpëtim Shehu, Drejtor Finance Anëtar;
 - f) Z. Sofjan Jaupaj, Këshilltar pranë ministrit Anëtar;


g) Znj. Elira Dani, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator Anëtar;

3. Grupi i punës ngarkohet me detyrat si më poshtë:

- a) Përcaktimin e kuadrit ligjor në lidhje me kërkesën për shprehje interesi dhe vijimësi e praktikës.
 - b) Shqyrtimin e materialeve për gjendjes e godinës së TK.
 - c) Vlerësimin dhe mjetet e disponueshme financiare ne dispozicion të buxhetit të Ministrisë së Kulturës.
 - d) Vlerësimin mbi interesin publik që paraqet godina e TK;
 - e) Procedurën dhe hapat ligjore që do të ndiqen në vijmësi;
 - f) Grafikon me afatet kohore deri në finalizimin e procesit
4. Për ecurinë e këtij procesi, si dhe çdo problematikë tjetër që lidhet me përmbajtjen e objektit të grupi të punës, kryetari i saj informon Sekretarin e Përgjithshëm.
5. Ngarkohet Grupi i punës të përfundojë raport vlerësimin me propozime konkrete për ecurinë e mëtejshme të procedurës.
6. Ngarkohet grupi i punës ta përcjelle për miratim raport vlerësimin Ministrit të Kulturës brenda datës 20/5/2018.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës për njoftimin e këtij urdhri, si dhe grupi i punës për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I SHQIPËRIE-SË
E KULTURËS**
Mirela KUMBARO-FURXHI



Konc; E.Dani

Pranoi: R. Xhaja

L. Beqiraj

Miratoi: O.Muzaka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 3427/Prot

datë 6 05 .2018

MEMO

LËNDA: Informacion mbi kërkesën për shprehje interesi të paraqitur nga Bashkia
Tirane

Drejtuar: Znj. Mirela Kumbaro, Ministër

Për dijeni: Z. Oltjon Muzaka, Sekretar i Përgjithshëm

HAPAT PROCEDURIAL NE LIDHJE ME KERKESEN E BASHKISE TIRANE PER NDERTIMIN E TEATRIT KOMBETAR TE RI

I. NE LIDHJE SHPREHJEN E INTERESIT PER ZHVILLIMIN E ZONES

Nga Bashkia Tirane është paraqitur kërkesa me nr. 6848/1 datë 23.2.2018 e cila ka përcjell pranë Ministrisë së Kulturës kërkesën për shprehje interesi mbi zhvillimin e zones pranë Teatrit Kombëtar, të subjektit "Fusha" shpk. Në përbërje të kësaj kërkesë subjekti privat angazhohet që përveç zhvillimit të pronës në pronësi të tij, të realizojë edhe ndertimin e Godinës të re të teatrit Kombëtar konform një projekti që do të miratohet nga të gjitha strukturat përkatëse.

Pas shqyrtimit të kërkesës, MK me shkresën datë 29.3.2018 i kthen përgjigje BT ku i parashton pengesat për të realizuar vet investimin lidhur me fondet në dispozicion si dhe i kërkon Bashkisë Tiranë informacion më të plotë lidhur me projektin e propozuar nga subjekti privat.

Me shkresën nr. 6848/6, datë 14.5.2018 të Bashkisë Tiranë, kjo e fundit i ka përcjellë MK të gjithë informacionin që disponon lidhur me investimin, pronen dhe orjentimin ligjor për realizimin e investimit.

Po kështu, në lidhje me objektin e TK, vet institucioni i është drejtuar Institutit të Ndërtimit me shkresën nr. 186/1, datë 9.3.2018 ku i ka kërkuar vlerësimin e gjendjes së godinës.

Me shkresën nr. 75/1, datë 23.3.2018 Instituti i Ndërtimit i ka kthyer përgjigje TK duke i bashkëlidhur TK raport mbi vlerësimin teknik të godinës.

II. BAZA LIGJORE

Pas shqyrtimit të propozimit, Grupi i Punës vlerëson se baza ligjore e nevojshme për të vlerësuar të gjithë procesin është si më poshtë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 41 1. E drejta e pronës private është e garantuar. 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. 4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë. 5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 78 1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. 2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

Neni 83 1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nën dhe në tërësi. 2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.

2. Kodi Civil i RSH (Kreu II);
3. Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtëshme të shtetit” i ndryshuar;
4. Ligj nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtëshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar;
5. Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”;
6. Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”;
7. (Neni 26) i Vendim i KM nr.392, datë 8.4.2009, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”.
8. VKM 867, datë 10.012.2014 “Për procedurat e bashkpunimit në institucionet e administratës shtetërore”

III. INSTITUCIONET BASHKEPUNUESE PER KETE PROCEDURE

1. Kryeministria
2. Bashkia Tiranë
3. Ministria e Drejtësisë
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë
5. Ministria e Kulturës

IV. VLERËSIMI MBI GJENDJEN E GODINËS

Ministria Kulturës është përgjegjëse jo vetëm për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë por edhe për garantimin e infrastrukturës për institucioneve e kulturës, në përputhje me standardet bashkëkohore, referuar kjo sigurisë, komfortit etj.

Bazuar në vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar të bërë nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 75/1, datë 23.3.2018 rezulton se:

1. Arkitektura. Referuar normativave për projektimin kushtet aktuale të godinës së Teatrit Kombëtar nuk janë të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve për të cilat është projektuar. Ato janë pothuajse jashtë normave të projektimit të godinave të këtij

- lloji. Ambientet nuk ofrojnë kushte optimale jo vetëm për stafin, por edhe për spektatorët.
2. Struktura Ndërhyrja në strukturën e objektit sado e madhe të jetë, nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit. Për arsyen se:
 - a) Objekti është konceptuar si një strukturë e lehtë dhe e përkohshme,
 - b) Themelet janë të vazhduara dhe të cekëta. Për këto tipologji objektesh parashikohen vetëm ndërhyrje të pjesshme dhe jo kapitale, afati i shërbimit të tyre është relativisht i ulët.
 - c) Betonet e përdorura dhe hekuri janë të markave të ulëta,
 - d) Ndërhyrjet ndër vite si shtesa, rikonstruksione, etj, kanë përkeqësuar punën e konstruksionit të objektit.
 - e) Kodet e projektimit, që përdoren në kohën e ndërtimit të objektit nuk marrin parasysh një sërë kriteresh projektimi që sot konsiderohen shumë të rëndësishme.
 3. Sistemet teknike (sistemi i mbrojtjes ndaj zjarri, elektrik, i ngrohjes, kushteve higjieno-sanitare, etj, janë jashtë normave të projektimit të godinave me karakter kulturor.
 4. Vlerat e trashëgimisë Objekti i TK vlerësuar nga ekspertët e fushës nuk mbart vlera të spikatura të arkitekturës së kohës në të cilën është ndërtuar kjo edhe për faktin se :
 - a) Objekti është ndërtuar në vitin 1938, si një objekt i përkohshëm për të plotësuar shërbimet e kërkuara për një kryeqytet.
 - b) Objekti asnjëherë nuk është vlerësuar me status mbrojtje, si shumica e objekteve të ndërtuar në këtë periudhë në qytetin e Tiranës.

Për sa më sipër godina e TK referuar vlerësimit të eksperteve jo vetëm që nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor lidhur me anën funksionale, sigurinë e strukturës sistemet e ruajtjes nga zjarri, elektrik, ngrohjes etj por edhe nëse kryet rikonstruksioni i saj, sado i kushtueshëm dhe i thellë të jetë nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit.

V. VLERESIMI FINANCIAR

Ministria e Kulturës është shprehur që nuk disponon mjetet e mjaftueshme financiare për realizimin e këtij investimi, për më tepër nuk e ka parashikuar këtë investim as në PBA (2018-2020).

Duhet të theksojmë që në katërvjeçarin e kaluar dhe në vazhdimësi Ministria e Kulturës është angazhuar në investimin e shumë objekteve social-kulturore të cilat kanë zënë një peshë të konsiderueshme në buxhetin e saj. Ndër investimet më të rëndësishme janë:

Rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambit Popullor me vlerë investimi sipas kontratës së nënshkruar në masën 1,112,105,226 leke;

Projekti i investimit për ndërtimin e qendrës multifunktionale “Skëna e Re” me vlerë investimi sipas kontratës së nënshkruar në masën 455,522,886 lekë.

Është parashikuar realizimi i projektzbatimit për investimin në Muzeun Historik Kombëtar në masën prej 40,000,000 lekësh që më pas do të shoqërohet me vlerën e zbatimit, si dhe realizimi i projektzbatimit të rikonstruksionit të GKA në masën prej 12,000,000 lekësh edhe ky do të shoqërohet me vlerën për zbatimin e projektit.

Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykon se Ministria e Kulturës e ka të pamundur të parashikojë fond investim për objektin e Teatrit Kombëtar, duke patur parasysh edhe tavanet buxhetore.

VI. VLERESIMI PER INTERESIN PUBLIK

Një vështrim mbi Teatrin Kombëtar

Teatri Kombëtar, krijoi bazat e trupave të para teatrore dhe profesioniste midis viteve 1844-1945, si prodhues i artit skenik gjithashtu edhe si një shkollë e artit teatror kombëtar, ndër vite zhvilloi dhe promovoi vlerat më sublime të kulturës shqiptare në mbarë hapësirën shqiptare.

Veprimtaria e Teatrit Kombëtar, nxiti zhvillimin e artit, si krijimtari shpirtërore si vlerë të identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave teatrore e artistike; eksperimentimit dhe formave të reja të shprehjes skenike; realizimit të veprave teatrore të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale; shkëmbimeve në veprimtari ndërkombëtare, turne, festivalet, manifestime intelektuale, riprodhimeve audiovizive dhe botimeve, me përparësi për audiencën shqiptare, duke synuar veçanërisht nxitjen e krijimtarisë kombëtare.

Teatri prodhon projekte artistike nga ku angazhon një gamë të madhe njerëzish (regjisor, aktorë, skenograf, reparte prodhimi, garderoba, rekuizitë, skena, foni etj.), që synojnë promovimin e Artit dhe kulturës Teatrore në Shqipëri, duke transmetuar vlerat më të mira të Teatrit Shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve.

Në TK u rritën dhe u afirmuan regjisorët e plejadës së parë si Sokrat Mio, Pandi Stillu, Andrea Malo, për të mbërritur në një stad të lartë pjekurie profesionale me regjisorët Pirro Mani, Kujtim Spahivogli, Mihal Luarasi, Fatos Haxhiraj, Dhimitër Pecani, Agim Qirjaqi, Gëzim Kame, ndërsa pas viteve '90 me një brez të ri regjisorësh si Altin Basha, Kiço Londo, Hervin Çuli, Mehmet Xhelili, Arben Kumbaro, Alfred Bualoti etj.

Pjesë të kujtesës historike dhe kombëtare, bëjnë pjesë artistët e mëdhenj shqiptar si Mihal Popi, Naim Frashëri, Kadri Roshi, Sulejman Pitarka, Loro Kovaçi, Pjetër Gjoka, Sandër Prosi, Ndrek Luca, Marie Logoreci, Violeta Manushi, Robert Ndrenika, Prokop Mima, Margarita Xhepa, Drita Pelingu, Ndrek Shkjezi, Gjon Karma apo aktorë të brezit tjetër si Agim Qirjaqi, Roland Trebicka, Ndriçim Xhepa, Yllka Mujo, Fatos Sela, Luiza Xhuvani, Fadil Kujovska, Ahmet Pasha, Bujar Lako, Bujar Asqeriu, Rajmonda Bulku etj. Skenografët më në zë kanë qenë: Rrok Daberdaku, Hysen Devolli, Agim Zajmi, Shaban Hysa, Kristo Çala etj.

Edukimi i brezave të rinj përmes kulturës së teatrit, shërben si vendi i ngjizjes së gjeneratave të artistëve dhe dramaturgëve të së ardhmes. Gjithashtu teatri, është ajo formë arti ku individi pasurohet, emancipohet intelektualisht dhe estetikisht dhe përmirëson mënyrën e të sjellurit dhe të shprehurit, si forma më e mirë për të kulturuar një komunitet.

Problematika që lidhen me godinën ekzistuese të Teatrit Kombëtar.

1. Në nëntor 2014, drejtori Hervin Çuli bëri një kërkesë për një skanim të anës së majtë të godinës së Teatrit Kombëtar, si dhe mendimin nëse aktorët duhet vazhdojnë normalisht aktivitetin e tyre.
2. Në përgjigje të kësaj shkrese Ministria, pas inspektimit të kryer në dukje se këto ambiente janë jashtë kushteve teknike. Për rrjedhojë, udhëzoi izolimin e këtyre ambienteve me panele ndarëse, deri në një ndërhyrje të dytë.

3. Në nëntor 2015, në funksion të krijimit të kushteve sa më normale për spektatorët edhe aktorët gjatë performancës në skenë, u realizua ngrohja e ambientit të skenës me kalidajë.
4. Në vitin 2016, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve miraton projektin “Ndërhyrje emergjente në repartin e zdhruktëtarisë së Teatrit Kombëtar”.

Problematika në parametrat e sektorëve të prodhimit dhe administrimit:

1. Sistemi i ndriçimit punon në pjesën më të madhe, akoma me aparatura kineze nga vitet e diktaturës, megjithëse është realizuar pjesërisht zëvendësimi i tyre, në vlera minimale. Ka mangësi të theksuara në mixera, dimëra, prozhektore, profajla etj, të parametrave të ndryshëm. Duke marrë parasysh koston e lartë që ka sistemi i ndriçimit zëvendësimeve të disa prozhektoreve dhe blerjes së dimerave është realizuar në masë të kufizuar.
2. Investimi, vecanërisht i pajisjeve për repartin e marangozëve është akut, pasi ky repart vazhdon të punojë me mjete të para 25 viteve. Mungesa e paisjeve bazë përbën rrezik për aksident në punë, pa marrë parasysh cilësinë e dobët të punimeve në kushte të mungesës së mjeteve të punës.
3. Pajisje për sistemin e fonisë (boxe, amplifikator, mixer etj). Edhe ky repart ka mangësi në pajisje si boxera të ndryshëm, amplifikatorë etj. Pajisjet e sotme të fonisë nuk janë bashkëkohore dhe janë tejet të vjeteruara. Edhe në këta sektorë ka shumë vite që nuk janë bërë investime duke marrë parasysh se aparaturat elektronike e kanë kohën e amortizimit të plotë brenda pak viteve.
4. Në vitin 2012 u bë rikonstruksioni i 6 dhomave të zhveshjes së aktorëve, nga ku pavarësisht mungojnë pajisjet me orendi, si portmanto, karrige , tavolina etj. Po kështu ka më shumë se dhjetë vjet që nuk janë blerë pajisje zyresh dhe kryesisht karrige pune, dollape etj.
5. Si rezultat i amortizimit të paisjeve kompjuterike dhe elektronike, për mbarvajtjen në punë, investimi e tyre është bërë domosdoshmëri.

Pavarësisht ndërhyrjeve të realizuara nga Ministria e Kulturës, godina e Teatrit Kombëtar është një godinë totalisht jashtë çdo funksioni dhe që nuk plotëson asnjë kusht teknik për ekzistencën dhe funksionimin normal të saj.

Nëpërmjet një investimi të ri bashkëkohor, do përmirësohej infrastruktura e pajisjeve, cilësia e prodhimit dhe teknologjisë së produksioneve dhe do të sigurohet tradita e aktiviteteve në Teatrin e ri Kombëtar, duke e sjellë atë në parametrat bashkëkohor.

Në përputhje me politikat e programit Artit dhe Kulturës, nevoja e ndërtimit të një teatri të ri bashkëkohor duhet të jetë i menjëhershëm.

Nëpërmjet këtij projekt-investimi, synohet krijimi i një teatri me salla shfaqjesh bashkëkohore dhe me standarte të larta evropiane, që do të jap ndikim dhe impakt të lartë në;

- Krijimin e një hapësirë e re qytetare;
- Përmirësimin e marrëdhënies me spektatorin duke zgjeruar gamën e aktiviteteve dhe hapësirave të reja alternative artistike;
- Rritjen e kapaciteteve të veprimtarisë së Teatrit Kombëtar (European);
- Përmirësimin në mënyrë të ndjeshme të kushteve bazë për realizimin në kohë dhe me cilësi të premierave dhe repertorit të institucionit.
- Rritjen e cilësisë profesionale që mundësojnë vënien në skenë të veprave që kërkojnë infrastrukturë të konsoliduar dhe efikasitet duke ju përgjigjur standarteve të artit bashkëkohor.
- Rritje e projekteve që gjenerohen nga skena e pavarur artistike;
- Sigurimin e parametrave optimal në të gjithë sektorët e prodhimit dhe administrimit;
- Sigurimin e vazhdimësisë të aktivitetit artistik dhe realizimin në kohë të veprës;
- Përmirësimin e infrastrukturës si një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë të Teatrit Kombëtar.

- Përmirësimin në cilësinë e jetës artistike, aksesit të kulturës dhe përcjelljen e artit në jetën social-kulturore.

Të gjitha këto, kanë një impakt të padiskutueshëm në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe ofertës kulturore ndaj publikut, artëdashësve dhe artistëve të artit skenik duke garantuar kushtet akomoduese dhe teknike-artistike në Teatrin Kombëtar, duke intensifikuar bashkëpunimet me teatrot si motra në rajon e më gjerë si dhe rritjen e fluksit të artëdashësve, audiencës artistike.

VII. PROPOZIME PËR KM

Per ecurine e metëjshme të kësaj procedure duke parë kompleksitetin e çështjes në fjalë, në procesin e shqyrtimit të kësaj praktike duhen përfshirë sipas ligjit edhe institucionet të cilat prekin fushat përkatëse jo vetëm Ministria e Kulturës e cila mbulon fushë e politikave në kulturë, por edhe:

- Ministria e Drejtësisë, nepërmjet të cilës do vendoset angazhimi i Avokaturës së Shtetit për kontratat dhe veprimet juridike të cilat parashikojnë detyrime me shtetin, ku inetersi publik është i lartë, bazuar në VKM 867, datë 10.012.2014 “Për procedurat e bashkpunimit ne institucionet e administratës shtetërore”, si dhe për të vlerësuar mbi formën juridike që do të ndiqet për zgjidhjen e propozimit në fjalë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomise, në rolin e përfaqësuesit të pronarit shtet bazuar edhe ne pikën 16 te VKM 503, datë 13.9.2017 “Per percaktimin e fushes se pergjegjesise shteterore te Ministrise se Financave dhe Ekonomise” për vlerësimin e aspektit financiar të investimit dhe vlerësimin e projektit të propozuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në VKM nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, për hartimin dhe zbatimin e politikave në zhvillimin urban,dhe të

Grupi i punes

Z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm

Kryetar;

Znj. Kozeta Angjeliu, Drejtor

Anëtar;

Zj. Herida Duro, Drejtor

Anëtar;

Z. Arian Avrazi, Drejtor

Anëtar;

Z.Shpëtim Shehu, Drejtor

Anëtar

Z. Sofjan Jaupaj, Këshilltar

Anëtar;

Znj. Elira Dani, Përgjegjës Sektori

Anëtar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 3427/Prot

datë 16.05.2018

MEMO

LËNDA: Informacion mbi kërkesen për shprehje interesi të paraqitur nga Bashkia Tirane

Drejtuar: Znj. Mirela Kumbaro, Ministër

Për dijeni: Z. Oltjon Muzaka, Sekretar i Përgjithshëm

HAPAT PROCEDURIAL NE LIDHJE ME KERKESEN E BASHKISE TIRANE PER NDERTIMIN E TEATRIT KOMBETAR TE RI

I. NE LIDHJE SHPREHJEN E INTERESIT PER ZHVILLIMIN E ZONES

Nga Bashkia Tirane është paraqitur kërkesa me nr. 6848/1 datë 23.2.2018 e cila ka përcjell pranë Ministrisë së Kulturës kërkesën për shprehje interesi mbi zhvillimin e zones pranë Teatrit Kombëtar, të subjektit “Fusha” shpk. Në përbërje të kësaj kërkesë subjekti privat angazhohet që përveç zhvillimit të pronës në pronësi të tij, të realizojë edhe ndertimin e Godinës të re të teatrit Kombëtar konform një projekti që do të miratohet nga të gjitha strukturat përkatëse.

Pas shqyrtimit të kërkesës, MK me shkresën datë 29.3.2018 i kthen përgjigje BT ku i parashton pengesat për të realizuar vet investimin lidhur me fondet në dispozicion si dhe i kërkon Bashkisë Tiranë informacion më të plotë lidhur me projektin e propozuar nga subjekti privat.

Me shkresën nr. 6848/6, datë 14.5.2018 të Bashkisë Tiranë, kjo e fundit i ka përcjellë MK të gjithë informacionin që disponon lidhur me investimin, pronën dhe orjentimin ligjor për realizimin e investimit.

Po kështu, në lidhje me objektin e TK, vet institucioni i është drejtuar Institutit të Ndërtimit me shkresën nr. 186/1, datë 9.3.2018 ku i ka kërkuar vlerësimin e gjendjes së godinës.

Me shkresën nr. 75/1, datë 23.3.2018 Instituti i Ndërtimit i ka kthyer përgjigje TK duke i bashkëlidhur TK raport mbi vlerësimin teknik të godinës.

II. BAZA LIGJORE

Pas shqyrtimit të propozimit, Grupi i Punës vlerëson se baza ligjore e nevojshme për të vlerësuar të gjithë procesin është si më poshtë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 41 1. E drejta e pronës private është e garantuar. 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. 4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë. 5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 78 1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. 2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

Neni 83 1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nën dhe në tërësi. 2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.

2. Kodi Civil i RSH (Kreu II);

3. Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtëshme të shtetit” i ndryshuar;

4. Ligj nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtëshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar;

5. Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”;

6. Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”;

7. (Neni 26) i Vendim i KM nr.392, datë 8.4.2009, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”.

8. VKM 867, datë 10.012.2014 “Për procedurat e bashkpunimit në institucionet e administratës shtetërore”

III. INSTITUCIONET BASHKEPUNUESE PER KETE PROCEDURE

1. Kryeministria

2. Bashkia Tiranë

3. Ministria e Drejtësisë

4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë

5. Ministria e Kulturës

IV. VLERËSIMI MBI GJENDJEN E GODINËS

Ministria e Kulturës është përgjegjëse jo vetëm për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë por edhe për garantimin e infrastrukturës për institucioneve të kulturës, në përputhje me standardet bashkëkohore, referuar kjo sigurisë, komfortit etj.

Bazuar në vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar të bërë nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 75/1, datë 23.3.2018 rezultoi se:

1. Arkitektura. Referuar normativave për projektimin kushtet aktuale të godinës së Teatrit Kombëtar nuk janë të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve për të cilat është projektuar. Ato janë pothuajse jashtë normave të projektimit të godinave të këtij

- lloji. Ambientet nuk ofrojnë kushte optimale jo vetëm për stafin, por edhe për spektatorët.
2. Struktura Ndërhyrja në strukturën e objektit sado e madhe të jetë, nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit. Për arsyen se:
 - a) Objekti është konceptuar si një strukturë e lehtë dhe e përkohshme,
 - b) Themelet janë të vazhduara dhe të cekëta. Për këto tipologji objektesh parashikohen vetëm ndërhyrje të pjesshme dhe jo kapitale, afati i shërbimit të tyre është relativisht i ulët.
 - c) Betonet e përdorura dhe hekuri janë të markave të ulëta,
 - d) Ndërhyrjet ndër vite si shtesa, rikonstruksione, etj, kanë përkeqësuar punën e konstruksionit të objektit.
 - e) Kodet e projektimit, që përdoren në kohën e ndërtimit të objektit nuk merrnin parasysh një sërë kriteresh projektimi që sot konsiderohen shumë të rëndësishme.
 3. Sistemet teknike (sistemi i mbrojtjes ndaj zjarri, elektrik, i ngrohjes, kushteve higjieno-sanitare, etj, janë jashtë normave të projektimit të godinave me karakter kulturor.
 4. Vlerat e trashëgimisë Objekti i TK vlerësuar nga ekspertët e fushës nuk mbart vlera të spikatura të arkitekturës së kohës në të cilën është ndërtuar kjo edhe për faktin se :
 - a) Objekti është ndërtuar në vitin 1938, si një objekt i përkohshëm për të plotësuar shërbimet e kërkuara për një kryeqytet.
 - b) Objekti asnjëherë nuk është vlerësuar me status mbrojtje, si shumica e objekteve të ndërtuar në këtë periudhë në qytetin e Tiranës.

Për sa më sipër godina e TK referuar vlerësimit të eksperteve jo vetëm që nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor lidhur me anën funksionale, sigurinë e strukturës sistemet e ruajtjes nga zjarri, elektrik, ngrohjes etj por edhe nëse kryet rikonstruksioni i saj, sado i kushtueshëm dhe i thellë të jetë nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike të sotme sipas kodeve të projektimit.

V. VLERESIMI FINANCIAR

Ministria e Kulturës është shprehur që nuk disponon mjetet e mjaftueshme financiare për realizimin e këtij investimi, për më tepër nuk e ka parashikuar këtë investim as në PBA (2018-2020).

Duhet të theksojmë që në katërvjeçarin e kaluar dhe në vazhdimësi Ministria e Kulturës është angazhuar në investimin e shumë objekteve social-kulturore të cilat kanë zënë një peshë të konsiderueshme në buxhetin e saj. Ndër investimet më të rëndësishme janë:

Rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambit Popullor me vlerë investimi sipas kontratës së nënshkruar në masën 1,112,105,226 leke;

Projekti i investimit për ndërtimin e qendrës multifunktionale “Skena e Re” me vlerë investimi sipas kontratës së nënshkruar në masën 455,522,886 lekë.

Është parashikuar realizimi i projektzbatimit për investimin në Muzeun Historik Kombëtar në masën prej 40,000,000 lekësh që më pas do të shoqërohet me vlerën e zbatimit, si dhe realizimi i projektzbatimit të rikonstruksionit të GKA në masën prej 12,000,000 lekësh edhe ky do të shoqërohet me vlerën për zbatimin e projektit.

Për sa më sipër, Grupi i Punës gjykon se Ministria e Kulturës e ka të pamundur të parashikojë fond investim për objektin e Teatrit Kombëtar, duke patur parasysh edhe tavanet buxhetore.

VI. VLERESIMI PER INTERESIN PUBLIK

Një vështrim mbi Teatrin Kombëtar

Teatri Kombëtar, krijoi bazat e trupave të para teatrore dhe profesioniste midis viteve 1844-1945, si prodhues i artit skenik gjithashtu edhe si një shkollë e artit teatror kombëtar, ndër vite zhvilloi dhe promovoi vlerat më sublimë të kulturës shqiptare në mbarë hapësirën shqiptare.

Veprimtaria e Teatrit Kombëtar, nxit zhvillimin e artit, si krijimtari shpirtërore si vlerë të identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave teatrore e artistike; eksperimentimit dhe formave të reja të shprehjes skenike; realizimit të veprave teatrore të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale; shkëmbimeve në veprimtari ndërkombëtare, turne, festivalet, manifestime intelektuale, riprodhimeve audiovizive dhe botimeve, me përparësi për audiencën shqiptare, duke synuar veçanërisht nxitjen e krijimtarisë kombëtare.

Teatri prodhon projekte artistike nga ku angazhon një gamë të madhe njerëzish (regjisor, aktorë, skenograf ..., reparte prodhimi, garderoba, rekuizitë, skena, foni etj..), që synojnë promovimin e Artit dhe kulturës Teatrore në Shqipëri, duke transmetuar vlerat më të mira të Teatrit Shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve.

Në TK u rritën dhe u afirmuan regjisorët e plejadës së parë si Sokrat Mio, Pandi Stillu, Andrea Malo, për të mbërritur në një stad të lartë pjekurie profesionale me regjisorët Pirro Mani, Kujtim Spahivogli, Mihal Luarasi, Fatos Haxhiraj, Dhimitër Pecani, Agim Qirjaqi, Gëzim Kame, ndërsa pas viteve '90 me një brez të ri regjisorësh si Altin Basha, Kiço Londo, Hervin Çuli, Mehmet Xhelili, Arben Kumbaro, Alfred Bualoti etj.

Pjesë të kujtesës historike dhe kombëtare, bëjnë pjesë artistët e mëdhenj shqiptar si Mihal Popi, Naim Frashëri, Kadri Roshi, Sulejman Pitarka, Loro Kovaçi, Pjetër Gjoka, Sandër Prosi, Ndrek Luca, Marie Logoreci, Violeta Manushi, Robert Ndrenika, Prokop Mima, Margarita Xhepa, Drita Pellingu, Ndrek Shkjezi, Gjon Karma apo aktorë të brezit tjetër si Agim Qirjaqi, Roland Trebicka, Ndiriçim Xhepa, Yllka Mujo, Fatos Sela, Luiza Xhuvani, Fadil Kujovska, Ahmet Pasha, Bujar Lako, Bujar Asqeriu, Rajmonda Bulku etj. Skenografët më në zë kanë qenë: Rrok Daberdaku, Hysen Devolli, Agim Zajmi, Shaban Hysa, Kristo Çala etj.

Edukimi i brezave të rinj përmes kulturës së teatrit, shërben si vendi i ngjizjes së gjeneratave të artistëve dhe dramaturgëve të së ardhmes. Gjithashtu teatri, është ajo formë arti ku individi pasurohet, emancipohet intelektualisht dhe estetikisht dhe përmirëson mënyrën e të sjellurit dhe të shprehurit, si forma më e mirë për të kulturuar një komunitet.

Problematika që lidhen me godinën ekzistuese të Teatrit Kombëtar.

1. Në nëntor 2014, drejtori Hervin Çuli bën një kërkesë për një skanim të anës së majtë të godinës së Teatrit Kombëtar, si dhe mendimin nëse aktorët duhet vazhdojnë normalisht aktivitetin e tyre.
2. Në përgjigje të kësaj shkrese Ministria, pas inspektimit të kryer vë në dukje se këto ambiente janë jashtë kushteve teknike. Për rrjedhojë, udhëzoi izolimin e këtyre ambienteve me panele ndarëse, deri në një ndërhyrje të dytë.

3. Në nëntor 2015, në funksion të krijimit të kushteve sa më normale për spektatorët edhe aktorët gjatë performancës në skenë, u realizua ngrohja e ambientit të skenës me kaldajë.
4. Në vitin 2016, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve miraton projektin “Ndërrhyrje emergjente në repartin e zdrukthëtarisë së Teatrit Kombëtar”.

Problematika në parametrat e sektorëve të prodhimit dhe administrimit:

1. Sistemi i ndriçimit punon në pjesën më të madhe, akoma me aparatura kineze nga vitet e diktaturës, megjithëse është realizuar pjesërisht zëvendësimi i tyre, në vlera minimale. Ka mangësi të theksuara në mixera, dimëra, prozhektore, profajla etj, të parametrave të ndryshëm. Duke marrë parasysh koston e lartë që ka sistemi i ndriçimit zëvendësimeve të disa prozhektoreve dhe blerjes së dimerave është realizuar në masë të kufizuar.
2. Investimi, vecanërisht i pajisjeve për repartin e marangozëve është akut, pasi ky repart vazhdon të punojë me mjete të para 25 viteve. Mungesa e paisjeve bazë përbën rrezik për aksident në punë, pa marrë parasysh cilësinë e dobët të punimeve në kushte të mungesës së mjeteve të punës.
3. Pajisje për sistemin e fonisë (boxe, amplifikator, mixer etj). Edhe ky repart ka mangësi në pajisje si boxera të ndryshëm, amplifikatorë etj. Pajisjet e sotme të fonisë nuk janë bashkëkohore dhe janë tejet të vjetëruara. Edhe në këta sektorë ka shumë vite që nuk janë bërë investime duke marrë parasysh se aparaturat elektronike e kanë kohën e amortizimit të plotë brenda pak viteve.
4. Në vitin 2012 u bë rikonstrukcioni i 6 dhomave të zhveshjes së aktorëve, nga ku pavarësisht mungojnë pajisjet me orendi, si portmanto, karrige , tavolina etj. Po kështu ka më shumë se dhjetë vjet që nuk janë blerë pajisje zyresh dhe kryesisht karrige pune, dollape etj.
5. Si rezultat i amortizimit të paisjeve kompjuterike dhe elektronike, për mbarvajtjen në pune, investimi e tyre është bërë domosdoshmëri.

Pavarësisht ndërhyrjeve të realizuara nga Ministria e Kulturës, godina e Teatrit Kombëtar është një godinë totalisht jashtë çdo funksioni dhe që nuk plotëson asnjë kusht teknik për ekzistencën dhe funksionimin normal të saj.

Nëpërmjet një investimi të ri bashkëkohor, do përmirësohet infrastruktura e pajisjeve, cilësia e prodhimit dhe teknologjisë së produksioneve dhe do të sigurohet tradita e aktiviteteve në Teatrin e ri Kombëtar, duke e sjellë atë në parametrat bashkëkohor.

Në përputhje me politikat e programit Artit dhe Kulturës, nevoja e ndërtimit të një teatri të ri bashkëkohor duhet të jetë i menjëhershëm.

Nëpërmjet këtij projekt-investimi, synohet krijimi i një teatri me salla shfaqjesh bashkëkohore dhe me standarte të larta evropiane, që do të jap ndikim dhe impakt të lartë në;

- Krijimin e një hapësirë e re qytetare;
- Përmirësimin e marrëdhënies me spektatorin duke zgjeruar gamën e aktiviteteve dhe hapësirave të reja alternative artistike;
- Rritjen e kapaciteteve të veprimtarisë së Teatrit Kombëtar (Europian);
- Përmirësimin në mënyrë të ndjeshme të kushteve bazë për realizimin në kohë dhe me cilësi të premierave dhe repertorit të institucionit.
- Rritjen e cilësisë profesionale që mundësojnë vënien në skenë të veprave që kërkojnë infrastrukturë të konsoliduar dhe efikasitet duke ju përgjigjur standarteve të artit bashkëkohor.
- Rritje e projekteve që gjenerohen nga skena e pavarur artistike;
- Sigurimin e parametrave optimal në të gjithë sektorët e prodhimit dhe administrimit;
- Sigurimin e vazhdimësisë të aktivitetit artistik dhe realizimin në kohë të veprës;
- Përmirësimin e infrastrukturës si një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë të Teatrit Kombëtar.

- Përmirësimin në cilësinë e jetës artistike, aksesit të kulturës dhe përcjelljen e artit në jetën social-kulturore.

Të gjitha këto, kanë një impakt të padiskutueshëm në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe ofertës kulturore ndaj publikut, artëdashësve dhe artistëve të artit skenik duke garantuar kushtet akomoduese dhe teknike-artistike në Teatrin Kombëtar, duke intensifikuar bashkëpunimet me teatrot si motra në rajon e më gjerë si dhe rritjen e fluksit të artëdashësve, audiencës artistike.

VII. PROPOZIME PËR KM

Per ecurine e metëjshme të kësaj procedure duke parë kompleksitetin e çështjes në fjalë, në procesin e shqyrtimit të kësaj praktike duhen përfshirë sipas ligjit edhe institucionet të cilat prekin fushat përkatëse jo vetëm Ministria e Kulturës e cila mbulon fushë e politikave në kulturë, por edhe:

- Ministria e Drejtësisë, nepërmjet të cilës do vendoset angazhimi i Avokaturës së Shtetit për kontratat dhe veprimet juridike të cilat parashikojnë detyrime me shtetin, ku inetersi publik është i lartë, bazuar në VKM 867, datë 10.012.2014 “*Për procedurat e bashkpunimit ne institucionet e administratës shtetërore*”, si dhe për të vlerësuar mbi formën juridike që do të ndiqet për zgjidhjen e propozimit në fjalë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomise, në rolin e përfaqësuesit të pronarit shtet bazuar edhe ne piken 16 te VKM 503, datë 13.9.2017 “*Per percaktimin e fushes se pergjegjesise shtetore te Ministrise se Financave dhe Ekonomise*” për vlerësimin e aspektit financiar të investimit dhe vlerësimin e projektit të propozuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në VKM nr. 504, datë 13.09.2017 “*Për percaktimin e fushës së pergjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*”, për hartimin dhe zbatimin e politikave në zhvillimin urban dhe të

Grupi i punes

Z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm

Kryetar;

Znj. Kozeta Angjeliu, Drejtor

Anëtar;

Zj. Herida Duro, Drejtor

Anëtar;

Z. Arian Avrazi, Drejtor

Anëtar;

Z. Shpëtim Shehu, Drejtor

Anëtar

Z. Sofjan Jaupaj, Këshilltar

Anëtar;

Znj. Elira Dani, Përgjegjës Sektori

Anëtar;